



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 45
Prishtinë, më 27.04. 2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Haset Cakolli, Mark Krasniqi, Donika Kadaj –Bujupi dhe Dragan Dimiq.

Munguan Adem Hajdaraj dhe Memli Krasniqi.

Në mbledhje prezantuan: rektori i Universitetit të Prishtinës prof.dr. Mujë Rugova përfaqësuesi i OSBE - së, NDI - së, përfaqësues nga mediat, përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 20.04.2010
3. Informatë nga ministri i MASHT rreth punës së Institucioneve arsimore të pa licencuara në Kosovë;
4. Diskutim rreth çështjeve aktuale në rektorat
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit se për shkak të udhëtimit jashtë vendit nuk ka mund të merr pjesë në mbledhje drejtoresha kompetente për të informuar për pikën e tretë të rendit të ditës, andaj kjo pikë shtyhet për mbledhjen e radhës.

Heset Cakolli propozoi që nën pikën të ndryshme të shqyrtohet kërkesa e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Senatit të Universitetit të Prishtinës.

Më këto propozime u pajtuan anëtarët e Komisionit, dhe u miratua rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20.04.2010.

3. Diskutim rreth çështjeve aktuale në rektorat

Arsim Rexhepi, kryetar njoftoi rektorin se Komisioni në kuadër të aktiviteteve të veta ka edhe çështjen e monitorimit të Ligjeve në fuqi.

Një ndër çështjet që kohëve të fundit po debatohet është çështja që lidhet me pensionimin e rektorit i cili e mban pozitën e rektorit përkundër profesorëve të Universitetit që kanë kaluar moshën 65 vjeçare dhe që gjatë vitit kanë marrë vendimet për pensionim nga vetë rektori.

Kryesuesi kërkoj sqarim nga rektori edhe lidhur me deklaratën e sekretarit të UP-së, i cili kishte deklaruar në media se secili person që e mbërrin moshën e pensionimit e humb të drejtën e ushtrimit të detyrës së rektorit, si dhe sqarim rreth argumentimit të politizimit të këtij institucioni.

Prof.dr. Mujë Rugova, tha se Rregullorja në fuqi e UNMIKut 2003/2 është në fuqi dhe se duhet zbatuar, mirëpo duke ditur rëndësinë që ka pasur dhe që ka Universiteti i Prishtinës gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të Kosovës dhe kontributit të madh që kanë dhënë profesorët universitarë në këto rrjedha, është e nevojshme që për këtë çështje të gjendet një zgjidhje më e favorshme, sepse moshë 65 vjeçare për pensionimin profesorëve universitare ashtu siç përcaktohet me këtë rregullore është e hershme.

Rugova vlerësoi se një pjesë e kuadrit të UP-së është i pazëvendësueshëm dhe kur bëhet fjalë për çështje të tilla nuk e përjashton mundësinë që rregullorja duhet tejkaluar.

Kur bëhet fjalë për kuadrot, mendon se është gabim i madh nëse nxirren profesorët në pension me këtë moshë, ai është idhtar i asaj që profesorët me bagazh shkencor e profesional në Universitet të mbeten të mbeten kuadër i nevojshëm për zhvillimin e shkencës dhe arsimit në Republikën e Kosovës.

Rugova foli edhe për qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të vitit 2008 për zgjatjen e mandatit të profesorëve të Universitetit, i cili qëndrim nuk është nënshkruar dhe nuk është jetësuar, dhe në këtë aspekt mendon se Kuvendi do duhej të debatonte për këtë çështje.

Heset Cakolli tha se çështja që po debatohet është e rëndësisë së veçantë.

Ai tha se çështja e rektorit i përket Këshillit Drejtues të rektoratit, dhe se kjo përcaktohet qartë me nenin 25 dhe 32 të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Ndërsa çështja e statusit të profesorëve do duhej të zgjedhet me një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Donika Kadaj-Bujupi mendon se dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut janë të tejkaluara dhe pajtohet me mendimin e rektorit kur është fjala te profesorët e universitetit të cilët duhet të kenë një trajtim të veçantë. Ajo tha se Komisioni duhet të merret me amendamentimin e Ligjit për Sherbyesit Civilë dhe kur është fjala për profesorët e fakulteteve, ata duhet të kenë një trajtim të veçantë.

Drita Kadriu konsideron se do duhej që të debatohet për cilësinë e mësimin në Universitet, ndërsa për çështjen për të cilën po debatohet shprehet e rezervuar.

Enis Kervan, pajtohet me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për çështjen e pensionimit të profesorëve universitarë dhe mendon që duhet gjetur menyra për rregullimin e kësaj çështje në mënyrë ligjore.

Mark Krasniqi mendon se çështja e pensionimit të profesorëve të Universitetit duhet të rregullohet dhe të shiqohet mundësia e zgjatjes së punës së profesorëve ashtu siç është e paraparë edhe në vendet në rajon.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që të shikohen mundësitë për amendamentimin projektligjeve përkatëse në mënyrë që të rregullohet çështja e pensionimit të profesorëve universitarë, që mosha e pensionimit të profesorëve universitarë të zgjatet.

4. Të ndryshme

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me propozimin për ndryshimin e emërimit të Fakultetit të Kulturës Fizikë në atë “Fakulteti i Shkencave Sportive” sipas shkresës së Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të datës 19.4.2010, si dhe pëlqimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës të datës 12.11.2009. Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Komisioni e konsideron të arsyeshëm emërtimin e ri të këtij Fakulteti dhe i Rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë ndryshimin e emërimit të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Fakultetin e Shkencave Sportive.

Kryesuesi në vazhdim foli për çështjen e angazhimit të ekspertëve nga lëmi të ndryshme, në veçanti nga lëmia e arsimit dhe e kulturës.

Ai në vazhdim e njoftoi anëtarët e Komisionit se ka kërkuar nga OSBE që t’a mbështesë Komisionin në sigurimin e ekspertëve për nevojat e Komisionit. Me këtë rast propozoi emrat e dy ekspertëve Kujtim Shala dhe Nysret Krasniqi, profesorë në Universitetin e Prishtinës, për t’u angazhuar në cilësinë e ekspertëve pranë Komisionit.

Kryesuesi, njëkohësisht kërkoi nga anëtarët e Komisionit nga rradhët e minoriteteve që të propozojnë ekspertë nga lëmitë e cekura më lart.

Anëtarët e Komisionit, shprehën kërkesën që kjo çështje të diskutohet si pikë e veçantë e rendit të ditës duke konsideruar se është e nevojshme që të përpilohet një listë me ekspertë të propozuar si dhe që këta ekspertë të sigurojnë Komisionin me

dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që anëtarët e Komisionit të informohen në lidhje me të arriturat e tyre.

Diskutimi u përqëndrua në kriteret që do të përdoren për zgjedhjen e këtyre ekspertëve dhe nëse këta ekspertë do të zgjedheshin nga Kuvendi i Kosovës apo nga organizata që i financon.

Komisioni u pajtua që kjo çështje të diskutohet në mbledhjen e rasdhës.

Donika Kadaj-Bujupi, foli për inicimin e një bashkëpunimi me Ambasadën e Shqipërisë, me Komisionin homolog dhe njoftoi lidhur me kontaktet në këtë aspekt me qëllim të që zhvillohet një vizitë në Shqipëri.

Enis Kervan njoftoi Komisionin se nga data 9 deri më 12 qershor 2010 është konfirmuar nga Ambasada Turke se Komisioni do të bëjë një vizitë në Parlamentin e Turqisë.

Drita Kadriu kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të ftohet ministri i kulturës në mënyrë që të diskutohet lidhur me kërkesat që dalin nga Plani i Veprimit për këtë fushë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 13: 40

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Arsim Rexhepi